

LIGJ
Nr.8302, datë 12.3.1998

**PËR ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE QË KRIJOHEN NË PYJE DHE KULLOTA -
PASURI SHTETËRORE**

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Të ardhurat e pyjeve dhe kullotave - pasuri shtetërore, që përfitohen nga shitja e lëndës drusore, tarifat e kullotjes, bimëve eterovajore-tanifere, gjuetisë dhe të ardhurat nga veprimtaritë e tjera që do të përcaktohen me ligj, administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave.

Neni 2

Në të ardhurat e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji, nuk përfshihen financimet nga buxheti i shtetit dhe financimet nga donatorët e huaj për realizimin e projekteve të ndryshme në sektorin e pyjeve dhe kullotave.

Neni 3

Të ardhurat, siç përcaktohen në nenin 1, ndahen ndërmjet buxhetit të shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëngjitet këtij ligji. Ato mbahen në llogari rrjedhëse të veçantë në bankë.

Neni 4

Kriteret për administrimin e të ardhurave që mbeten në Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave, përcaktohen nga bordi këshillimor i Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave.

Drejtori i Përgjithshëm i Pyjeve dhe Kullotave përcakton kriteret e ndërtimit, të drejtat, detyrat dhe përbërjen e këtij bordi.

Neni 5

Të ardhurat që krijohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave, sipas lidhjes bashkëngjitur, do të përdoren për:

- punime pyjore (përmirësime pyjore, pyllëzime, fidanishte);
- sisteme malore dhe mbrojtjen e tokës nga erozioni;
- mbrojtjen e faunës e të biodiversitetit të pyjeve dhe kullotave;
- ndërtimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve pyjore;
- parandalimin e sëmundjeve, dëmtuesve dhe zjarreve në pyje e kullota;
- mbarështimin e pyjeve dhe kullotave;
- kërkime shkencore në pyje;
- krijimin e kushteve për kryerjen e veprimtarive turistike dhe çlodhëse.

Neni 6

Çdo dispozitë tjetër ligjore që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ndarja e të ardhurave nga pyjet dhe kullotat

Lidhja nr.1

Shpallur me dekretin nr.2022, datë 21.3.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani